



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2019, mori këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SHTATORES SË KOMANDANTIT
LEGJENDAR ADEM JASHARI

- I. **MIRATOHET** Vendimi për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jasharit, në cepin e hapësirës së ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, në Prishtinë.
- II. Lokacioni për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari, shtrihet në parcelën kadastrale nr. 5761-0, ZK Prishtinë, ku sipas Geoportalit, kjo parcelë figuron e pandarë, ndërsa në regjistrin kadastral, sipas pjesës tekstuale, kjo parcelë figuron e ndarë në 7 pjesë dhe shtatorja vendoset në pjesët e parcelave me ndarje dhe pronësi, si: 5761-1 P.sh. KK Prishtinë, 5761-2 P.sh, KK Prishtinë, 5761-4 P.sh, KK Prishtinë, 5761-5 P.sh, KK Prishtinë, sipas certifikatave nga Drejtoria e Kadastrit.
- III. Ky vendim paraqet bazë për vendosjen e kësaj shtatoreje.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është ortofoto e lokacionit.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-0276651/19, më 11.11.2019



KRYESUESI I KUVENDIT

Agim Kuleta

A R S Y E T I M

I Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari

Komuna e Drenasit dhe Komuna e Skenderajt me kërkesën me nr. 14-070/01-0251075/19 të dt. 11.10.2019 të protokolluar në Komunën e Prishtinës drejtuar kryetarit të Komunës së Prishtinës ka kërkuar caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jasharit.

Sipas kërkesës, kryetari i Skenderajt Bekim Jashari dhe kryetari i Drenasit Ramiz Lladrovci kanë vizituar dhjetëra herë vendin e propozuar për shtatore, në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës dhe sipas tyre ky ambient dhe mjedis jetësor, nuk është i përshtatshëm për personalitetin e papërsëritshëm të historisë së re, Adem Jasharit. Shtatorja do të gjendej jashtë aortës së Kryeqytetit, duke zvogëluar rëndësinë historike dhe shprehjes së respektit të qytetareve ndaj këtij personaliteti unik.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartë cekur nga Komuna e Drenasit dhe Komuna e Skenderajt dhe në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie ka identifikuar lokacionin për vendosjen e shtatores, e cili gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013 sipas të cilit kjo zonë është paraparë të jetë për institucion qeveritar. Lokacioni për vendosjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jasharit, shtrihet në parcelën kadastrale nr. 5761-0 ZK Prishtinë, ku sipas Geoportalit kjo parcelë figuron e pa ndarë, ndërsa në regjistrin kadastral sipas pjesës tekstuale kjo parcelë figuron e ndarë në 7 pjesë dhe shtatorja vendoset në pjesët e parcelave me ndarje dhe pronësi si: 5761-1 P.sh. K.K Prishtinë, 5761-2 P.sh, K.K Prishtinë, 5761-4 P.sh, K.K Prishtinë, 5761-5 P.sh, K.K Prishtinë, sipas certifikatave nga Drejtoria e Kadastrit. Sipas Drejtorisë së Pronës parcela kadastrale me nr.5761-0, ZK Prishtinë, është e parcelizuar para vitit 1999 në 7 njësi kadastrale.

Vendosja e shtatores së komandantit legjendar Adem Jasharit është propozuar të jetë në cepin e hapësirës së ndërtesës së Qeverisë, përball "Unionit", ndërmjet "Unionit" dhe Ndërtesës së Qeverisë, afër tabelës për personat e pagjetur. Sipas tyre vendosja e shtatores së Komandantit legjendar në mes të Heroit kombëtar Skënderbeut dhe ish Presidentit Rugova, do ta sulmonte epokën e re të historisë, çlirimit dhe lirisë së vendit tonë.

Bazuar në gjendjen faktike konstatohet se hapësira se ku do të vendoset shtatorja është sipërfaqe e gjelbëruar andaj gjatë vendosjes së shtatores duhet t'i kushtohet kujdes të veçantë ambientit.

Bashkangjitur:

Ortofoto e lokacionit,

Kërkesa nga Komuna e Drenasit dhe Komuna e Skenderajt

Lokacionit i propozuar për vendosjen e shtatores;



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC
Nr. 01-463/01-59569
Më
On 11 / 10 / 2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJT
Nr. 01-463/01-0062975/19
Data
11 / 10 / 2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit dhe Skenderajt



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINA
SKENDERAJT
11-10-2019
14-010/01-0251075/19

DATE/A:	11.10.2019
PËR/ZA/TO:	Z. Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës;
CC:	Z. Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës; Asambleistëve të Kuvendit Komunal të Prishtinës;
NGA/OD/FROM:	Kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lledrovci Kryetari i Komunës së Skenderajt, z. Bekim Jashari
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jasharit

I nderuari Kryetar Ahmeti,

Uroj që kjo shkrësë e jona t'ju gjej shëndosh e mirë Juve dhe Familjen Tuaj.

Nëpërmjet kësaj shkrese, duam të shprehim shqetësimin tonë, lidhur me një çështje, sa të ndjeshme, aq të rëndësishme për opinionin.

Së bashku me Kryetarin e Skenderajt, Bekim Jasharin, kemi vizituar dhjetëra herë vendin e propozuar për shtatore, në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Prishtinës.

Ky vend, ambient dhe mjedis jetësor, nuk është i përshtatshëm për personalitetin e papërsëritshëm të historisë së të re, Adem Jasharit. Shtatorja do të gjendej jashtë aortës së Kryeqytetit, duke zvogëluar rëndësinë historike dhe shprehjes së respektit të qytetarëve ndaj këtij personaliteti unik.

Propozojmë:

I nderuar z. Ahmeti, me mirëkuptim, presim të trajtoni me durim dhe dashamirësi, propozimin tonë për vendin e shtatores së komandantit legjendar, Adem Jasharit.

Lokacioni për ngritjen e shtatores të jetë në cepin e hapësirës së ndërtesës së Qeverisë, përball "Unionit", ndërmjet "Unionit" dhe Ndërtesës së Qeverisë, afër Tabelës për personat e pagjetur.

Vendosja e shtatores së Komandantit legjendar në mes të Heroit kombëtar Skënderbeut dhe ish Presidentit Rugova, do ta sublimonte epokën e re të historisë, çlirimit dhe lirisë së vendit tonë.

I nderuar Kryetar Ahmeti, shpresoj që të gjeni kohë e mundësi ta trajtoni propozimin, i cili do të ishte sa meritë, aq dinjitoz, për të gjithë neve.

Me nderim dhe përshëndetje të sinqerta, Ramiz Lladrovci dhe Bekim Jashari.

P.S. Ky vendim për lokacionin, do ta lehtësonte edhe vendosjen e shtatores, më 28 Nëntor të këtij viti. Shtatorja e cila do të vendoset në Sheshin " Fehmi Lladrovci" në Drenasit, do të ishte zgjidhje e propozuar për shqyrtim, se cila aktualisht është në proces të kthimit në bronz.



